

VENDIM
Nr. 36/2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE NIVELIT TË PAGAVE
PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me vendimin nr. 85/2022, datë 17.11.2022; me vendimin nr. 115/2023, datë 2.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 2/a, të ligjit nr. 10 405 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” dhe nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën Shqipërisë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

Lidhja nr. 1.

STRUKTURA, ORGANIKA DHE NIVELI I PAGAVE I AKADEMISË SË SHKENCAVE

(ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 17.11.2022; me vendimin nr. 115/2023, datë 2.11.2023)

DREJTIMI INSTITUCIONAL SHKENCOR

Pozicioni	Nr.	Kategoria
KRYESIA	4	
Kryetar	1	C (0,700)
Zëvendëskryetar	1	D (0,650)
Sekretar shkencor	1	D (0,650)
Sekretare e Kryesisë (Kryesekretare)	1	III-3
SEKSIONET SHKENCORE		
Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (anëtar Kryesie)	1	E (0,600)
Sekretar teknik i SSHSHA-së	1	IV-1
Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)	1	E (0,600)
Sekretar teknik i SSHTN-së	1	IV-1
QENDRA E PROJEKTEVE DHE KOORDINIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR	3	
- Drejtor	1	II-1
- Koordinator kërkimor-shkencor	2	III-3

ADMINISTRATA

KANCELARI	1	I-2
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN	3	
- Përgjegjës sektori	1	III-1
- Specialist për burimet njerëzore dhe jurist	1	III-3
- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1	IV-1
SEKTORI I BOTIMEVE SHKENCORE	6	
- Përgjegjës sektori	1	III-1
- Redaktor shkencor (Specialist)	1	IV-1
- Redaktor shkencor (Specialist)	1	IV-1
- Bibliografe (Specialist)	1	IV-1
- Bibliotekare (Specialist)	1	IV-1
- Editor botimesh	1	Kl. IX
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS	4	
- Përgjegjës sektori	1	III-1
- Specialist finance	1	IV-1
- Specialist për shpërndarjen e librit akademik	1	IV-2
- Magazinier/shofer (institucionit)	1	Kl. VIII
SEKTORI NDIHMËS		
- Shofer i kryetarit	1	Kl. V
- Punëtor mirëmbajtës	1	Kl. VI
- Punonjës pastrimi	1	Kl. II
- Arkivist-protokollist (Specialist)	1	IV-2
TOTALI		29

Shënime.

i. Koeficientët e kategoritë C, D dhe E për pagat e anëtarëve të Kryesisë janë në raport me pagën e Presidentit e sipas kategorive të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar me ligjin nr. 34/2023.

ii. Klasifikimi i pagave të nëpunësve të institucionit të Akademisë së Shkencave i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023.

iii. Klasifikimi i pagave për punonjësit mbështetës/administrativë të institucionit të Akademisë së Shkencave i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023.